



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Date/Date:

145
04.05.2026

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPSTINA KOSOVO POLJE

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit Nr. 493, të datës 16.04.2026 për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetjake 2025, bartja në vitin 2026 dhe bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit 2024-2025, për shpenzime në vitin 2026', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 6, nenin 8, paragrafi 1.2, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 10/L-001 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2026), nenin 27, shkronja (c, ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 493, të datës 16.04.2026 për rritjen e të hyrave vetjake në vitin 2025, bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të vitit 2025 për shpenzim në vitin 2026

1. Për rritjen e të hyrave vetjake të buxhetit të komunës për vitin 2025, në shumën e mjeteve financiare prej: 643,820.93€ dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026, në nën - programet e kategorisë ekonomike mallëra dhe shërbime si vijon:
 - 1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 65,000.00€, bartet për shpenzim në nën - programin Nr. 16902 - Zyrën e Kuvendit Komunal;
 - 1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 178,820.93€, bartet për shpenzim në nën - programin Nr. 18162 - Infrastruktura Publike;
 - 1.3 Shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00€, bartet për shpenzim në nën - programin Nr. 73150 - Shërbimet e Shëndetësisë Primare;
 - 1.4 Shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00€, bartet për shpenzim në nën - programin Nr. 92010 - Administrata e Arsimit;
2. Për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara dhe të pa alokuara nga të hyrat vetjake të viteve 2024-2025, në shumën e mjeteve financiare të përgjithshme prej; 3,377,261.46€, për shpenzim në vitin 2026, në nën - programet dhe kategoritë ekonomike: Paga dhe shtesa, mallëra e shërbime, subvencione e transfere dhe shpenzime kapitale të ndara si në vijim:

- 2.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 9,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa në nën - programin Zyra e Kryetarit Nr. 16002;
- 2.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 2,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa në nën - programin Administrata e Shëndetësisë Nr. 73011;
- 2.3 Shuma e mjeteve financiare prej: 2,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa në nën - programin Integritet Evropian Nr. 16542;
- 2.4 Shuma e mjeteve financiare prej: 4,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa në nën - programin Shërbimet Sociale Nr. 75506;
- 2.5 Shuma e mjeteve financiare prej: 20,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa në nën - programin 'Shkolla e Mesme Teknike Minatori' Nr. 94231;
- 2.6 Shuma e mjeteve financiare prej: 15,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa në nën - programin 'Shkolla e Mesme Ekonomike Hoxhë Kadri Prishtina' Nr. 94232;
- 2.7 Shuma e mjeteve financiare prej: 20,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Administrata Nr. 16302;
- 2.8 Shuma e mjeteve financiare prej: 138,751.15€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Inspektimet Nr. 16603;
- 2.9 Shuma e mjeteve financiare prej: 120,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002;
- 2.10 Shuma e mjeteve financiare prej: 196,166.56€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Infrastruktura Publike Nr. 18162;
- 2.11 Shuma e mjeteve financiare prej: 30,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik Nr. 48002;
- 2.12 Shuma e mjeteve financiare prej: 20,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare Nr. 73150;
- 2.13 Shuma e mjeteve financiare prej: 15,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Mallëra dhe Shërbime në nën - programin Administrata e Arsimit Nr. 92010;
- 2.14 Shuma e mjeteve financiare prej: 500,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Subvencione dhe Transfere në nën - programin Infrastruktura Publike Nr. 18162;
- 2.15 Shuma e mjeteve financiare prej: 50,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve: Subvencione dhe Transfere në nën - programin Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik Nr. 48002;

- 2.16 Shuma e mjeteve financiare prej: 40,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002, në Kodin e projektit me Nr. 54261 - Asfaltimi në Fushë-Kosovë, rruga 'Hajrullah Zymi', me infrastrukturë përcjellëse, trotuari, ndriçim, kanalizim;
- 2.17 Shuma e mjeteve financiare prej: 27,905.46€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002, në Kodin e projektit me Nr. 55818 - Asfaltimi në Fushë-Kosovë, rrugët 'Amir Elmazi', 'Mumin Gashi', 'Struga', 'Pellazgët'.
- 2.18 Shuma e mjeteve financiare prej: 74,960.24€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002, në Kodin e projektit me Nr. 55992 - Rregullim në Fushë-Kosovë, rruga 'Dardania' trotualet, ndriçim, largimi i terrasave, sinjalizimi, infrastruktura elektrike - faza e I parë;
- 2.19 Shuma e mjeteve financiare prej: 66,499.84€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002, në Kodin e projektit me Nr. 55993 - Rikonstruim i rrugëve: trotuare, ndriçim, infrastruktura elektrike dhe e telefonisë, shtegu i bicikletave në rrugët 'Hajrullah Zymi', 'Hamdi Grajçevci', 'Enver Maloku'.
- 2.20 Shuma e mjeteve financiare prej: 235,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002, në Kodin e projektit me Nr. 20932 - Asfaltimi në rrugët 'Maxhera', 'Qyqalla', 'Nënhekurudha' dytësore, 'UÇK Bardhi', 'Rashica', '22 Qershori', 'Rruga e Shehrit'.
- 2.21 Shuma e mjeteve financiare prej: 24,837,71€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Rrugore Nr. 18002, në Kodin e projektit me Nr. 55995 - Rregullimi i hapësirave në rrugët 'UÇK Bardhi i Madh' me trotuare, ndriçim, gjelbrim, Sllatinë 2, Pomozotin, Grabovc.
- 2.22 Shuma e mjeteve financiare prej: 58,543.25€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Publike Nr. 18162, në Kodin e projektit me Nr. 54205 - Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre në rrugët 'Bedri Pejani', 'Tahir Zemaj', 'Hamdi Grajçevci', '1 Tetori', 'Pajazit Islami', Sllatinë e Madhe rruga 'Lloburja', 'Mali', 'Prekadini', 'Lagjet 028, 029', 'Mëshari'.
- 2.23 Shuma e mjeteve financiare prej: 226,137,60€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Publike Nr. 18162, në Kodin e projektit me Nr. 56231 - Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatrat: Harilaç, Grabovc, dhe Fushë-Kosovë - Lagjen 028;
- 2.24 Shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën

- programin Infrastruktura Publike Nr. 18162, në Kodin e projektit me Nr. 20803 - Blerja e automjeteve - veturave, kamion me korpë, cisternë për pastrim të rrugëve;
- 2.25 Shuma e mjeteve financiare prej: 5,967.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Infrastruktura Publike Nr. 18162, në Kodin e projektit me Nr. 56435 - Ndriçim publik në rrugët 'Hajrullah Zymeri', Enver Maloku' 'Hamdi Grajçevci';
- 2.26 Shuma e mjeteve financiare prej: 921,296.06€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ me Nr. 66015, në Kodin e projektit me Nr. 49732 - Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit - fshatra dhe qytet;
- 2.27 Shuma e mjeteve financiare prej: 29,550.00€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Shërbimet Kulturore me Nr. 85002, në Kodin e projektit me Nr. 55960 - Ndërtimi i pllakave memoriale në Varrezat e Dëshmorëve në Fushë-Kosovë;
- 2.28 Shuma e mjeteve financiare prej: 198,449.11€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve investive publike në nën - programin Arsimi Parashkollor me Nr. 92230, në Kodin e projektit me Nr. 54303 - Ndërtimi i Qerdhës në Fushë-Kosovë - rruga 'Shukrije Obërtinca' dhe
- 2.29 Shuma e mjeteve financiare prej: 126,197.48€, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - realizimin e projekteve publike në nën - programin Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët me Nr. 93030, në Kodin e projektit me Nr. 54302 - Ndërtimi i shkollës fillore në Fushë-Kosovë rruga 'Fazli Grajçevci'.
3. Mjetet financiare të evidentuara në paragrafin 1, me nën - paragrafët 1.1 deri 1.4, tij të këtij vendimit, përfshinë dokumentin financiar të rritjes së të hyrave vetjake në vitin 2025, në shumën e mjeteve financiare prej: 643,820.90€ dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026, në kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve.
4. Mjetet financiare të bartjes së buxhetit të komunës të pa shpenzuar dhe të pa alokuar në vitet 2024 dhe 2025, ku bëjnë pjesë mjetet financiare në shumën prej: 3,377.261.46€, nga kategoria ekonomike e rezervës të pa alokuara për shpenzim në vitin 2024 dhe mjeteve financiare që barten për shpenzim janë në shumën prej: 3,377,261.46€, të evidentuara në paragrafin 2, me nën - paragrafët 2.1 deri në 2.29, shpenzohen në kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon
- 4.1 Për kategorinë ekonomike të pagave dhe shtesave nga 2.1 deri në 2.6;
- 4.2 Për kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve nga 2.7 deri në 2.13;
- 4.3 Për kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve nga 2.14 deri në 2.15 dhe
- 4.4 Për kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale - për realizimin e projekteve investive publike nga 2.16 deri në 2.29.
5. Shuma e përgjithshme që bartet për shpenzim nga viti 2024 dhe 2025, për shpenzim në vitin 2026, nga shumat e evidentuara në paragrafët një dhe dy është në shumën e mjeteve financiare prej: 4,021,082.39€.

6. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendim, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit e Financave dhe Drejtorive tjera të Komunës, konform shumave të mjeteve financiare të shpërndara në kodet e nën programeve sipas kategorive ekonomike të përshkruar në arsyetimin e Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe në tabelën shtojcë e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

A r s y e t i m

Arsyetim për Paga dhe Shtesa, Mallëra dhe Shërbime, Subvencione dhe Transfere:

- Në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa do të plotësohet mungesa e mjeteve në vlerë prej 52,000.00€, për pagesën retroaktive sipas Vendimit të KPM, pagesat për punë gjatë natës, vëllim të punës dhe për pagesat e mësimdhensve për mesimin jo formal në Arsim.
- Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime do të plotësohet mungesa e mjeteve në vlerë prej 1,183,738.64€, për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm për pagesën e obligimeve-faturave 2025, për pagesën e punëtorëve me projekt, për projektin Hartimi i Projekteve Ideore dhe Kryesore, si dhe për mirëmbajtjen e qytetit, varrezave, pastrimin e rrugeve etj.
- Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, këto mjete janë ndarë në vlerë prej 550,000.00€, për ndertimin e objektit të Ndërmarrjes Publike Lokale si dhe për subvencionimin e startup.

Arsyetim për obligimet kontraktuale:

“Asfaltimi në Fushë-Kosovë: Rugët; "Amir Elmazi", "Mumin Gashi", "Struga", "Pellazget" kodi (55818), në vlerë prej 27,905.46€,

Deri më tani OE nuk ka arritur ti përfundoi disa pozicione sipas planit dinamik siç janë pozicionet: 4.10, 4.11, 4.12- pozicione këto që kanë të bëjnë me shtrimin e shtresave të asfaltit për këtë projekt, pasi që për këtë periudhë brenda planit të menaxhimit temperaturat kanë qenë mjaft të ulëta dhe me lagështi të madhe që ka rezultuar në zbutjen e trasesë së rrugës dhe nuk kanë qenë kushtet e duhura për asfaltim, sepse kriteret e ngjeshmerisë së trasesë së rrugës nuk janë arritë dhe për këtë arsye për tu realizuar ky projekt cilësor punimet janë ndërprerë përkohësisht deri në përmisimin e kushteve për vazhdimin e punimeve.

“Rregullimi në rrugën Dardania Fushë-Kosovë (trotuaret, ndriqimi, largimi i terrasave, sinjalizimi, infrastruktura elektrike), faza e I”. kodi (55992), duhet plotësuar në vlerë prej 74,960.24€, për finalizim të projektit, pasi që puna në terren është duke u realizuar sipas planit dinamik të kontratës.

“Rikonstruimi i rrugëve me: trotuare, ndriqimi, infrastruktura elektrike dhe e tele., shtegu i bicikletave në rrugët: "H. Zymi", "H. Grajqevci", dhe "E. Maloku", kodi (55993), në vlerë prej 66,499.84€, Pagesat për kontratën në fjalë nuk janë proceduar pasi punët nuk kanë qenë në përputhje me standardet e kërkuara dhe në vitin 2026 do të pranojmë situacione të cilat janë duke u realizuar (korrigjuara).

“Rregullimi i hapësirave në Rr."UÇK" në Bardh të Madh me trotuare, ndriqim, gjelbrim, Sllatina 2, Pomozotin, Grabovc”, kodi (55995), duhet të plotësohet në vlerë prej 24,837.71€. Me plan të menaxhimit është parapara të realizohet gjatë viteve 2025 dhe 2026. Vitin e kaluar për shkak të kushteve klimatike që kanë pamundësuar ekzekutimin e punimeve, punimet janë duke u realizuar tani.

“Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre: rruget Bedi Pejani, Tahir Zemaj, Hamdi Grajqevci, 1Tetori, Pajazit Islami,S.Madhe,rr.Lloburja, Mali Prekadini, lagjeja 028 dhe 029,Meshar”, kodi (54205), në vlerë prej 58,543.25€, Projekti ka kaluar afatinë kohor të paraparë mirëpo kanë mbetur vetëm punimet finale për mbyllje të kontratës. Kompania në dhjetor ka përfunduar punimet mirepo për shkak të disa vrejtyeve nuk i është bërë pagesa tash jemi në përpilimin e situacionit të fundit.

“Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatrat :Harilaç, Graboc dhe në Fushë-Kosovë lagjen 028”, kodi (56231), duhet plotësuar në vlerë prej 226,137.60€, për finalizim të projektit, pasi që puna në terren është duke u realizuar sipas planit dinamik të kontratës.

“Ndriqimi publik në rruget Hajrullah Zymi, Enver Maloku, dhe Hamdi Grajqevci ”, kodi (56435), në vlerë prej 5,967.00€, Projekti i lartëcekur nuk ka filluar punimet sepse ka qen i lidhur me projektin paraprak dhe nga mos realizimi i projektit paraprak ka mbetur i pa realizuar projekti në fjalë dhe është e pamundur të realizohet nëse nuk përfundon projekti.

“Ndertimi i kanalizimit dhe ujesjellesit (fshatra, qytet) ”, kodi (49732), në vlerë prej 921,296.06€, Kontrata nuk është realizuar për shkak të pengesave në terren, përfshirë zënien e pronës publike me objekte ekzistuese dhe pamundësin shpronësimit të parcelave për rreth . Si rezultat, punimet nuk kanë mundur të zhvillohen sipas planifikimit .

“Ndërtimi i pllakave memoriale (në varrezat e Deshmoreve në Fushë-Kosovë)”, kodi (55960), në vlerë prej 29,550€,” mosrealizimi i detyrimeve kontraktuale brenda afateve të përcaktuara në planin dinamik është pasojë e drejtpërdrejtë e planifikimit joadekuat kohorë të kontratave, të cilat janë lidhur në periudhë që përkon me sezonin dimëror. Si rrjedhojë, për shkak të kushteve klimatike të pafavorshme, ka qenë objektivist e pamundur vijimi i punimeve ndërtimore. Për më tepër, këto kontrata janë të shoqëruara edhe me vështirësi dhe çështje të tjera operative dhe teknike, të cilat aktualisht janë në trajtim dhe pritet të adresohen në vijim.

Ndertimi i Çerdhes në Fushe Kosovë në rr.Shukrije Obertinca”, kodi (54303), në vlerë prej 198,449.11€.

Ky projekt është ekzekutuar nga Thesari për Vendime Gjyqësore, pjesa tjetër nuk është bërë alokimi i mjeteve vitin 2025 për shkak të një gabimi teknik –kodi funksional, prandaj duhet plotësuar me bartje, me u aloku prandaj duhet plotësuar nga bartja.

“Ndërtimi i Shkollës Fillore në Fushe Kosove rr.Fazli Grajqevci”, kodi (54302), në vlerë prej 126,197.48€, ku sipas kushteve të veçanta të kontratës Neni. 30.1 (data e posedimit të vend punimit do të jetë 160 ditë pas nënshkrimit të kontratës) . Sipas kushteve të kontratës dhe planit të menaxhimit OE është dashur të përfundoj punë me dt. 24.10.2025, alokimi i mjeteve nuk është bërë në vitin 2025 për shkak të një gabimi teknik –kodi funksional, prandaj duhet plotësuar me bartje.

Arsyetim : Projektet e reja 2026

“Asfaltimi ne Fushë-Kosovë Rr.Hajrullah Zymi me infrastruktur percjellese (trotuaret,ndriqimi,kanalizimi)”, kodi (54261), në vlerë prej 40,000.00€, në mungesë të mjeteve gjatë planifikimit për vitin 2026 janë planifikuar vetëm 20,000.00 andaj me bartje duhet të plotësohet për finalizim të projektit.

“Asfaltimi në Bardh të Madh: Rrugët (Magjera, Qyqalla, Nënhekurudha-dytësore, UÇK Bardhi, Rashica, 22 Qershori ,Rruga e Shehrit) ", kodi (20932), në vlerë prej 235,000.00€, Me planifikimin e buxhetit 2026 nuk kemi pasur mjete të mjaftueshme për këtë projekt të shumë kërkuar nga qytetarët prandaj e kemi hapur kodin, andaj ky projekt duhet të plotësohet bartje të mjeteve të pa shpenzuara-pa alokuar THV 2025.

“Blerja e automjeteve (Veturave,Kamion me korpë, Cisternë për pastrim të rrugëve)”, kodi (20803), në vlerë prej 200,000.00€, me planifikimin e buxhetit 2026 nuk kemi pasur mjete të mjaftueshme për këtë projekt i cili është shumë i nevojshëm për komunën tonë, prandaj e kemi hapur kodin, andaj ky projekt duhet të plotësohet me bartje të mjeteve të pa shpenzuara-pa alokuar THV 2025, me qëllim të blerjes së Komioneve me korpe dhe cisternes, fshisa për pastrimin e rrugëve etj. Për tu paisur Ndërmarrja Publike Lokale e cila është e themeluar.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së BF, Drejtorateve tjera të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIMIN
Nrfaq/Be.ete. 146
Data/Datum. 04. 05. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit për revidimin e projektit për rregullimin në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë, trotuaret, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera', të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Infrastrukturës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, bjen këtë:

REKOMANDIM

1. Për aprovimin e Kërkesës së Drejtorisë së Infrastrukturës për revidimin e pjesëshëm të projektit për investime kapitale: Projekti i Infrastrukturës me emërtim në Kodin funksional Nr. 0451, Kodi i projektit Nr. 55992, me emërtim të projektit 'Rregullimi në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë, trotuaret, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera'.
2. Revidimi do të realizohet në përputhje me Kërkesën e Drejtorisë së Infrastrukturës, petitionin e qytetarëve dhe subjekteve afariste, me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të njerëzve, automjeteve dhe furnizimit me mallëra për subjektet afariste dhe marrjen e mbeturinave, në harmonizimin e përshkruar dhe të arsyetuar nga profesionistët dhe në bashkëpunim me menaxherin e kontratës, brenda parametrave të lejuar ligjorë dhe administrative, për zbatimin e kontratës nga ana e operatorit ekonomik në teren, në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.
3. Revidimi i pjesëshëm do të zbatohet nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Punëkryesi, që në aspektin e funksionalitetit paraqet një parakusht jetik, për zhvillimin e përgjithshëm të qytetit tonë në rrugën 'Dardania', në gjatësi prej: 480 metra në Fushë-Kosovë.
4. Ky revidim do të jetë pjesë përbërëse e projektit në zhvillim, të evidentuar në paragrafin një të këtij revidimi të propozuar nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe të dërguar për realizim punëkryesit dhe menaxherit të kontratës.

Rekomandimi i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Infrastrukturës, Punëkryesit, Menaxherit të Kontratës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Refer./Beatr. 147
Data/Batem. 04.05.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të parë të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike', të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në paragrafin një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe caktimit të taksave komunale vjetore për subjektet afariste, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimeve publike, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe Arkivës

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DRISKALAJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Be.ste. 148
Data/Date. 04.05.2026



OPŠTINA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Data: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të parë të 'Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike', të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të 'Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në paragrafin një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të shfrytëzimit të hapësirave publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimeve publike, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe Arkivës

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA E ADMINISTRATJES

Nr./faq./Bastk. 149
Datë/Date: 04.05.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të parë të 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës', të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës


1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës, e cekur në paragrafin një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të kushteve dhe kriterëve për ndarjen e subvencioneve nga komuna.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Rregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimeve publike, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtoritë e Komunës, që bëjnë ndarje të subvencioneve.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtoritë e të Komunës dhe Arkivës**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të parë të 'Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të 'Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në paragrafin një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe organizimit të lagjeve urbane në qytet dhe fshatrave në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimeve publike, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Administratës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Administratës dhe Arkivës

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DREJTORIA ZA ADMINISTRACIJU

Pr.faq/Dr.str. 151
Data/Date: 04.05.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrëfiksëve në Fushë-Kosovë', të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (g), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (e), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për realizimin e ndërtimit të objektit për Njësinë e Zjarrëfiksëve në Fushë-Kosovë

1. Për caktimin e lokacionit për realizimin e ndërtimit të objektit për Njësinë e Zjarrëfiksëve, në pronën komunale të evidentuar në certifikatën e pronës të datës 16.04.2026 për Ngastrën kadastrale Nr. P-72514036-01342-0, me sipërfaqe prej: S=19.59 në Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, matjeve gjeodezike dhe ndarjes grafike, për strukturimin e ndërtimit të objektit të evidentuar në paragrafin një të këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Gjeodezisë e Kadastrit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Agjensisë për Menaxhimin e Emërgjencave, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së GJK, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRIMËD - BUDŽETIARIA ADMINISTRIMIA
Nr. i Propozit. 152
Data/Procesi 04.05.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit me bari sintetik në fshatin Miradi e Epërme', të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit dhe renovimin e fushës së futbollit me bari sintetik në fshatin Miradi e Epërme

1. Për ndryshimin e lokacionit të projektit për renovimin e fushës së futbollit nga fshatit Lismir dhe realizimin e këtij renovimi të fushës së futbollit, me bari sintetik në fshatin Miradi e Epërme.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe realizimin e renovimit të cekur në paragrafin një të këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së KRS dhe Arkivës**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORA ZA ADMINISTRACIJU

Ref./Dok. 153

Data/Date: 04.05.2026

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024 për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël', të paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 53, të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 20/2016), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për anulimin e vendimit Nr. Nr. 76, të datës 21.05.2024 për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël

1. Për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024 për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së KRS dhe Arkivës**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Kërkesës Nr. 02-070/05-0012003/26, të datës 20.04.2026, për ndihmë në ndërtimin e Shtëpisë së djegur për palën Muhamet Berjani nga fshati Miradi e Epërme', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (k), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (gj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për kthimin e shqyrtimit të lëndës me Nr. 02-070/05-0012003/26, të datës 20.04.2026, në Komisionin për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për kthimin e shqyrtimit të lëndës me Nr. 02-070/05-0012003/26, të datës 20.04.2026, në Komisionin për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Kuvendi I Komunës i rekomandon Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të merrë një vendim në përputhje me mundësitë buxhetore të mjeteve financiare nga kategoria ekonomike për ndarjen e subvencioneve, për të ndihmuar palën Muhamet Berjani, i sëmurë psikikë në ndërtimin dhe akomodimin e shtëpisë së tij të djegur në fshatin Miradi e Epërme.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Komisionit për ndarje të subvencioneve në shëndetësi, duke respektuar aspektet e mirëqenies sociale, në përputhje me nenin 17, shkronja (k), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKSIONI I ADMINISTRATËS

Numri/Seriali: 155
Data/Numri: 05.05.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit Nr. 487, të datës 16.04.2026 për përmirësimin dhe harmonizimin e dokumentacionit tekstual dhe hartografik GIS për Zonën Komerciale të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2020-2028', të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Planifikimit Urban', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 50, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 20/2016), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin Propozimit Nr. 487, të datës 16.04.2026, për përmirësimin dhe harmonizimin e dokumentacionit tekstual dhe hartografik GIS për Zonën Komerciale në Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2020-2028

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 487, të datës 16.04.2026, për përmirësimin dhe harmonizimin e dokumentacionit tekstual dhe hartografik GIS për Zonën Komerciale në Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028, në procedurat për lëshimin e kushteve dhe lejeve ndërtimore për Zonën Komerciale, për bazë të merren kushtet zhvillimore të përcaktuara me Hartën Zonale Digjitale GIS.
2. Përmirësimi dhe harmonizimi tekstual dhe hartografik për Zonën Komerciale në Hartën Zonale të Komunës, i cekur në paragrafin një të këtij vendimi, zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe të përgjithshëm në Komunën e Fushë-Kosovës për zonën komerciale si vijon:
 - 2.1 ZK1, ZK2 dhe ZK3 në faqën Nr. 98;
 - 2.2 Në hartën digjitale kushtet zhvillimore të përshkruara për kodin ZK3 janë destinimi tregti dhe afarizëm;
 - 2.3 Indeksi i sipërfaqës ndërtuese ISN - 1.5;
 - 2.4 Shfrytëzimi I ngastrës kadastrale zhvillimore: ISHPKZH – 50%;
 - 2.5 Kodi i ZK përveç kodi i ri ZK3, faqe 103-108.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është harmonizimi i pjesë tekstuale dhe hartografike e evidentuar në paragrafin një dhe dy të këtij vendimi në dokumentin e planifikimit hapësinorë të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028.
- 4 Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

A r s y e t i m

Drejtorja e Planifikimit Urban e Komunës së Fushë-Kosovës, në procedurat e zhvilluara për kushte dhe leje ndërtimore, gjatë zbatimit të Hartës Digjitale të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028, janë identifikuar disa gabime teknike, ku ka mospërshtatje të kushteve zhvillimore të përshkruara në dokumentacionin tekstual me atë grafik të ‘Hartës Digjitale GIS’, për Zonat Komerciale. Këto gabime kanë pasur një ndikim të theksuar në krijimin e problemeve administrative dhe procedural për zbatimin e plotë të Hartës Zonale, për arsye të mos harmonizimit të dokumenteve për zbatim në Zonat Komerciale, andaj kemi propozuar që të bëhet harmonizimi dhe përmirësimi i pjesës tekstuale dhe hartografike të Hartës Zonale të Komunës. Duhet ta kemi parasysh faktin se harta ‘Digjitale GIS’, është produkti teknik ku është punuar dizajni i zonave, ndërsa dokumenti tekstual ka dështuar të reflektojë të dhënat e Hartës Zonale të Komunës, andaj është i domosdoshëm të bëhet ky përmirësim dhe harmonizim i përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së PU dhe Arkivës**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DRUŠTVA ZA ADMINISTRACIJU

Nrfaq/Bratr. 156

Data/Datum. 05.05.2026

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.05.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2026, pas shqyrtimit të ‘Propozimit për shpalljen e interesit publik për realizimin e projektit të asfaltimit të rrugës ‘Gurët e Gjatë’ në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç’, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Infrastrukturës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 4, nenin 7, nenin 8, të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare Nr. 52/2009), Ligjit për ndryshim plotësimin Nr. 03/L-205, të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr. 03/L-139, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

Për shpalljen e interesit publik për realizimin e projektit për asfaltimin e Rrugës ‘Gurët e Gjatë’ në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç

1. Për shpalljen e interesit publik për realizimin e projektit për asfaltimin e rrugës ‘Gurët e Gjatë’ në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç, për pronat private të evidentuara në Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale në sipërfaqe të përgjithshme prej: $S = 401m^2$ si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. 729-1 në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 729-2, në sipërfaqe prej: $S = 9 m^2$;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. 791-1 në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 791-2, në sipërfaqe prej: $S = 39 m^2$;
 - 1.3 Ngastra Kadastrale Nr. 1095-5 në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 1095-6, në sipërfaqe prej: $S = 59 m^2$;
 - 1.4 Ngastra Kadastrale Nr. 1095-3 në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 1095-4, në sipërfaqe prej: $S = 6 m^2$;
 - 1.5 Ngastra Kadastrale Nr. 237-7 në Zonën Kadastrale Harilaç, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 237-8, në sipërfaqe prej: $S = 72 m^2$;

- 1.6 Ngastra Kadastrale Nr. 237-9 në Zonën Kadastrale Harilaç, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 237-10, në sipërfaqe prej:
S = 92 m²;
 - 1.7 Ngastra Kadastrale Nr. 237-11 në Zonën Kadastrale Harilaç, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 237-12, në sipërfaqe prej:
S = 90 m²;
 - 1.8 Ngastra Kadastrale Nr. 237-13 në Zonën Kadastrale Harilaç, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 237-14, në sipërfaqe prej:
S = 26 m², si dhe;
 - 1.9 Ngastra Kadastrale Nr. 237-15 në Zonën Kadastrale Harilaç, për fillimin e realizimit të procedurës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës në NK. Nr. 237-16, në sipërfaqe prej:
S = 8 m².
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe realizimin e procedurave administrative, të shpronësimit të pronave private të cekur në paragrafin 1, nën - paragrafët 1.1 deri në 1.9, të këtij vendimi dhe vlerësimi i pronave nga institucionet e autorizuara me kompetencë për këtë çështje, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Gjeodezisë e Kadastrit dhe Drejtorisë së Infrastrukturës.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së GJK, Drejtorisë së INFSK dhe
Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**

